



PROGESVERBAL VII/2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së VII (shtatë) për vitin 2022 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 12.07.2022
Ora : 10:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës ;
3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;
4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;
5. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2021;
6. Informatë për aktivitetet e KKS-së për periudhën Janar-Qershor 2022;
7. Informatën për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën Janar-Qershor 2022;

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit, i njofton me rendin e ditës dhe e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - nuk ka vërejtje në procesverbal, Kryesuesi e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Dardan Berisha - ky me siguri nuk është i Komunës tonë.

Avni Bytyqi - është i Prizrenit, por e ka dhe adresën.

Dardan Berisha - ka qenë mirë me pas një skicë kadastrale. Sipas informatave prej gjithë atyre që e kanë marrë, pothuaj 95 % nuk e shfrytëzojnë dhe është mirë me pas në pasqyrë se si po funksionon Agrozona. Mbi 10 parcela mendoj që duhet mi shfuqizu vendimet, sepse nuk e shfrytëzojnë të drejtën e punës. Te afati i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të neni 2, bëhet fjalë për 99 vjet. A është gabim apo si?

Urim Suka - ky raport është i protokolum me 09.06.2021. Pse është vonu kaq shumë? Gjithëashtu kërkoj informacion më në detaje që ta dimë pak a shumë për çka po e votojmë.

Avni Bytyqi - kjo ka ardh 09.06.2021 dhe ka qenë në KPF mandatin e kalum, mirëpo me 15 qershor Presidentja i ka shpall zgjedhjet ,dhe si pasojë e shpalljes së zgjedhjeve ne kemi qenë të detyrur me

tërhek nga rendi i ditës deri me inaugurimin e organeve të reja. Në momentin kur u bë inaugurimi i organeve të reja, ne kemi pas edhe planin e punës. E kemi pas në muajin qershor këtë pikë, mirëpo për shkak të agjendës së ngjeshur i ka ardhë tash momenti për me fut në rend dite. Cilat parcela do të merr, mundeni mi pa në webfaqe të Komunës ose mundemi me ju dërgu një kopje të skicës. Sa i përket shfrytëzimit të Agrozonës është e vërtetë që kanë qenë 18 operatorë ekonomikë që kanë marrë prona aty. Sipas një rekomandimi nga komisioni i kalum, 9 kontrata i kemi ndërpre dhe aktualisht vetëm 4 operatorë janë duke e shfrytëzuar të drejtën e shfrytëzimit të pronës. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime tjera rreth pyetjeve.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Bulëza Kuçi - unë kërkoj mirëkuptim nga pozita. Të ketë edhe opozita një përfaqësues, pasi dy përfaqësues janë nga ekzekutivi, besoj që do të ishte më transparente.

Dardan Berisha - te projekt-vendimi, a ka mundësi mu cek edhe afati kohor. A ka me ekzistuar edhe komisioni i ankesave apo ka me qenë i njëjti komision?

Avni Bytyqi - neni 17 i ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme e obligon Komunën për çdo pronë të iniciojë procedurë për dhënie në shfrytëzim dhe të formoj komision. Komisioni ka mandat vetëm për atë pronë që është caktuar. Ndërsa komisioni i ankesave është me mandat 2 vjeçar.

Dardan Berisha - projekt-vendimi te formimi i komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë te neni tre dhe neni 4 mos është një gabim teknik?

Avni Bytyqi - po është gabim teknik. Do ta përmirësojmë.

Dardan Berisha - a ka mundësi me qenë i njëjti anëtar i komisionit edhe te afatgjatë dhe te afatshkurtër?

Avni Bytyqi - ligji nuk e specifikon në mënyrë decizive, por me vet faktin që ligjdhënësi e ka parapa që për çdo vendim paraprak me themel komision, kjo të jep me nënkuptuar që nuk lejohet të jetë i njëjti person çdo herë.

Urim Suka - uroj që komisionet me qenë transparente, gjithëpërfshirëse dhe jo njëanshëm.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë. Pasi nuk ka debat Kryesuesi e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2021;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - Vazhdimisht unë i kom ngrit disa tema. Mënyra se si ju po funksiononi është në kundërshtim edhe me procedurat ligjore, edhe me interesat e qytetarëve. Tash e kemi përpara një raport të Auditorit, i cili në një formë apo në një tjetër e vërteton atë që ne kemi thënë në vazhdimësi. Përveq këtij raporti me të gjetura, ka edhe plot të gjetura tjera të cilat dëshmojnë se mënyra se si po funksiononi ju

është për keqardhje dhe vërtet duhet me ndryshu këtë qasje.Unë dua ti përmend disa:1. Mos hartimi i projekteve ekzekutive për projekte kapitale.A dini sa është e rëndë që auditori të thotë që ti nuk ke hartu projekte ekzekutive për projekte kapitale. 2.Janë 2010 raste të pagesave të cilat kanë tejkaluar afatin ligjor.Vonesa e pagesave do të thotë neglizhencë e juaja dhe do të thotë një farë shantazhi që i bëhet firmave për me i kërku ryshfet që ai me ta kry pagesën më shpejt. 2010 operatorë kanë mujt me padit Komunën, dhe sa shumë humbje tjera ju i kishit kriju buxhetit me neglizhencën tuaj.3.Mangësi në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për subvencionim. 4. Përdorimi jo adekuat i procedurave të prokurimit. 6.Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë.Pra, përafërsisht në të gjitha sektoret auditori ka gjet shkelje.Ne,fjalën tonë kryesore do ta themi në Asamble.

Kryesuesi - unë pajtohem me ty por pjesërisht.Ka disa faktorë,por atë që ti e përmende te puna e ryshfetit,duhet me pas ni bazë dhe argument.Kjo është pak e rëndë ,por sidoqoftë është mendimi yt.

Urim Suka - unë ryshfetin nuk e thash me fakte.Se me pas fakte unë ta qes përpara.Unë po them që kjo len hapësirë për qatje.

Fadil Hoxha - dua ta argumentoj që puna e ryshfetit nuk qëndron.Me 12 dhjetor përfundojnë të gjitha llojet e zotimeve në bazë të ligjit dhe rregullores për menaxhimin e financave publike për përfundimin e vitit fiskal.Këtu janë:komunalitë,uji ,bërllogu dhe rryma.Zyrtari Kryesor financiar tutje jep sqarime.

Urim Suka - unë e kam përvojën për këtë.Ka ndodh që i kam pru tre fatura për një ditë,dhe njëra u pagu të nesërmen dhe dy tjarat 6 muaj janë vonu.30 ditë afat i ki dhe ti nuk e pagun.

Fadil Hoxha - nuk është gjithmonë ashtu si po thu,sepse ka edhe mungesa buxhetore herë pas here. Zyrtari Kryesor Financiar tutje jep sqarime.

Bulëza Kuçi - më la përshtypje përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak,ku nga 6 rekomandime që i kemi pas ,vetëm tre janë zbatu dhe tri më të rëndësishmet të cilat nuk janë zbatu.Fjalën më gjerësisht e marrim në Asamble.

Dardan Berisha - Me sa e kam lexu,ka shumë gjetje te zyra e prokurimit.Dhe ajo që më ka shqetëson është te rrugët që po bëhen,për projektet që përmendi kolegu Urimi. Ky raport i ka 11 rekomandime dhe prej tyre 8 janë rekomandime të reja dhe tri rekomandime të përsëritura.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Informatë për aktivitetet e KKS-së për periudhën Janar-Qershor 2022;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - Komuna jonë ka nevojë me diskutu për sigurinë në bashkësi sepse kemi raste të përsëritura dhe siguria nuk është në nivelin qysh qytetarët kanë nevojë.Ne kur u formu ky komision patëm dhanë kritikë tona,që ju po doni me formu një komision që është jo funksional,me njerëz qysh keni pas qef ju.Kur e lexon materialin e shoh që ato takime që ju i mani, lan me kuptu që janë takime të zbehta ,pa ide të qarta,janë takime që nuk po ndihmojnë për me zhvillu pjesën e sigurisë ma tutje dhe me dhanë rekomandime ma tutje.Te pjesa e arsimit pashë disa diskutime,por gati nuk u diskutu kurgja që është e rëndësishme për sigurinë e fëmijëve nëpër shkollë.Te pjesa,prishja e rendit dhe qetësisë publike thuhet se situata është e qetë përveq te një lokal në rr.”Hjadin Berisha”.Thuhet se është gjobit me dhjetra herë nga policia dhe inspektorët komunal,por kjo situatë mbetet të rishikohet nga organet kompetent që e kanë leju lejen. Kush e ka leju lejen?Pse të gjobitet 10 herë dhe jo të ndalet menjëherë.

Avni Bytyqi - këshilli është themelë konform udhëzimit.Sipas udhëzimit këshilli duhet ti mbaj së paku 6 takime varësisht nga nevoja.Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Urim Suka - themelimi i komisionit ndoshta më mirë të ish vonu si proces,dhe me gjet njerëz që janë të gatshëm me kontribu për sigurinë dhe ato takime me qenë frytdhënëse.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

Unanimisht Miratohet

**Pika 7. Informatën për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës
për periudhën Janar-Qershor 2022;**

Kryesuesi - është obligim i ekzekutivit që para Kuvendit ta paraqet raportin e dytë të shpenzimeve të buxhetit të vitit 2022. Kryesuesi hap debatin.

Fadil Hoxha - buxheti fillestar ka qenë 17.120.000, i alokum është 11.526.000 ose 67.33%.

Urim Suka - kërkon sqarime të tabela nr.2, të mallra dhe shërbime 100%.

Fadil Hoxha - sipas buxhetit fillestar aq janë bo edhe alokimet dhe të mallra dhe shërbime dhe të shpenzimet komunale dhe të investimet kapitale përveq pjesës që është në rezervë. Kjo forma si është, është me plan keshin e ri. Përpara alokimet nuk janë bo në formën sa është buxheti. Alokimet janë bo me tre mujorësh. Tani me plan kesh alokimet bëhen komplet sa është buxheti, kurse shpenzimet i planifikon vet se në cilën periudhë kanë me ndodh. Për mallra, komunali, kapitalet, sa ka qenë buxheti aq janë aloku, por nuk do të thotë që janë shpenzu. Kurse për pjesën e pagave ata vet e bojnë. Zyrtari Kryesor Financiar tutje jep sqarime rreth pjesës së shpenzimeve, dhe thotë se janë shpenzu 5.503.000, kurse të të hyrat vetanake, planifikimi është gjysma e buxhetit total të planifikuar të të hyrave vetanake dhe është 2.054.989, kurse janë realizu 949,255.31 euro. Pjesën më të madhe të të hyrave vetanake e bëjnë tatimi në pronë, që ka pësuar rënje, ku krahasuar me vitin e kaluar ka rënje 3.65 % dhe është pasojë e vendimit që regjistrimi i automjeteve nuk është i kushtëzuar.

Urim Suka - unë dua ta di sa është shpenzu buxheti për mallra dhe shërbime, sa për shpenzime komunale, sa subvencione dhe sa për kapitale? Sa % e keni shpenzu buxhetin?

Fadil Hoxha - 49.88 % është totali.

Labinot Halitjaha - herave tjera paret kanë ardhë në baza tre mujore dhe tash kanë ardhë përnjëherë.

Drejtori tutje jep sqarime.

Urim Suka - paraprakisht ma herët është thënë që duhet me na kuptu, se buxheti ndahet çdo tre mujor dhe ne skemi parë të alokume me zhvillu projektin. Ndërsa tash buxheti është aloku në shumicë dhe po thoni prap është problem.

Fadil Hoxha - nuk është problem.

Kryesuesi - kur është leju alokimi i mjeteve?

Fadil Hoxha - me 10 maj ka fillu pjesa e shpenzimit. Te projektet kapitale janë rreth 1 milion që janë në zotim dhe pritet për mu bo shpenzim. Shpenzimet kanë me ndodh në korrik, gusht dhe tutje. ZKF tutje jep sqarime.

Dardan Berisha - pagesat e faturave a bohen me 15?

Labinot Halitjaha - fatura ka afat 30 ditë.

Kryesuesi - e hedh në votim.

**4 për.1 apstenim
Miratohet pika 7**